

**VENDIM**  
**Nr.994, datë 2.7.2008**

**PËR TËRHEQJEN E MENDIMIT TË PUBLIKUT NË VENDIMARRJE PËR  
MJEDISIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 3 të konventës së Aarhusit, ratifikuar me ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I**  
**TË PËRGJITHSHME**

1. Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Konventë”, konventa “Për të drejtën e publikut për t’u informuar, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore” (konventa e Aarhusit), ratifikuar me ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.

b) “Autoritet publik”:

i) organet shtetërore qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore;

ii) personat fizikë ose juridikë, që kryejnë funksione publike, administrative, sipas ligjit, përfshirë dhe detyra, veprimtari ose shërbime të veçanta për mjedisin;

iii) çdo person tjetër fizik ose juridik, që ka përgjegjësi a funksione publike ose që ofron shërbime publike për mjedisin, nën kontrollin e një organi apo personi, të përmendur në nënndarjet (i) e (ii).

c) “Publik i ndikuar”, publiku i ndikuar, që mund të ndikohet apo që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore, që shprehin interes.

2. Termat e tjera, të përdorura në këtë vendim, kanë kuptimin e termave të përdorur në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

**KREU II**

**PJESËMARRJA E PUBLIKUT TË NDIKUAR NË HARTIMIN E POLITIKAVE, TË  
STRATEGJIVE DHE PLANEVE TË VEPRIMIT, NË ZBATIM TË TYRE, QË KANË LIDHJE  
ME MJEDISIN**

1. Pjesëmarrja e publikut në hartimin e politikave, të strategjive rajonale e kombëtare, të përgjithshme a sektoriale, dhe të planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumenteve, që përmirëson përmbajtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre.

2. Autoritetet publike gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të përmendura në pikën 1 të këtij kreu, pjesëmarrjen e publikut të ndikuar e realizojnë:

a) duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm për këto dokumente;

b) me përcaktimin e rregullave dhe të procedurave sa më të thjeshta;

c) me sigurimin e kushteve dhe të zgjidhjeve praktike, të përshtatshme për tërheqjen e mendimit të tij.

3. Për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe kontributin e tij, autoritetet publike, zbatojnë procedurat, si më poshtë vijon:

a) Në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e dokumentit të hartuar, e identifikojnë atë, që përbën publikun e ndikuar për rastin konkret;

b) Organizojnë njoftimin e publikut të ndikuar, se është hartuar projekti i dokumentit, që do të bëhet objekt i debatit publik dhe e ftojnë publikun të njihet me të e të përgatitet për debat.

4. Njoftimi i publikut të ndikuar bëhet nga autoriteti publik, që ka ndërmarrë hartimin e dokumentit. Njoftimi shpallet vazhdimisht gjatë 30 ditëve:

a) në radio e TV, kombëtare e vendore;

b) në faqen e internetit të autoritetit;

c) në botime, të përditshme apo periodike, nëse është e mundur;

ç) në tabelën e njoftimeve, në vend të dukshëm.

5. Njoftimi shoqërohet me:

a) të dhënat, në mënyrë të përmbledhur, të dokumentit, objekt debati, që orienton publikun në çështjet më kryesore, për të cilat kërkohen vërejtjet, sugjerimet e propozimet e tij;

b) përmbledhjen, të përgatitur në gjuhën shqipe, me terminologji të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun;

c) njoftimin e vendit, ku qëndron i depozituar teksti i plotë i projektit të dokumentit, për t'u lexuar nga publiku i ndikuar;

ç) përcaktimin e afatit kohor për dhënien e mendimit, i cili është jo më pak se 1 muaj nga data e fundit e shpalljes së njoftimit;

d) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të diskutimit me publikun e ndikuar.

6. Përfaqësuesit e organit, që ka hartuar projektin e dokumentit, drejojnë takimin, i krijojnë publikut lehtësi procedurale që përfaqësuesit e tij të shprehin lirisht, dhe mbajnë procesverbalin e takimit, ku regjistrohen të gjitha vërejtjet, sugjerimet e propozimet e publikut.

7. Grupi hartues i dokumentit e ripunon atë, duke marrë parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku, që vlerësohet i vlefshëm, dhe harton relacionin, që shoqëron projektdokumentin, ku pasqyrohen vërejtjet e publikut, që nuk janë reflektuar në të, duke shpjeguar edhe arsyet pse nuk janë marrë parasysh.

8. Relacioni i përcillet organit vendimmarrës, së bashku me projektin përfundimtar të dokumentit e me procesverbalin e debatit me publikun.

9. Dokumentet e përmendura në pikën 1 të kreut II të këtij vendimi, nuk mund të miratohen, nëse nuk plotësojnë kërkesat e këtij kreu, për tërheqjen e mendimit të publikut.

### KREU III

#### PJESËMARRJA E PUBLIKUT GJATË PËRGATITJES SË PROJEKTAKTEVE NORMATIVE PËR MJEDISIN

1. Për të siguruar pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së projektakteve normative mjedisore, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) ndërmer këto hapa:

a) Publikon matricën e akteve, që do të hartohen e miratohen gjatë vitit kalendarik, në të gjitha publikimet periodike të saj, të shkruara dhe elektronike;

b) Nëpërmjet strukturës përgjegjëse, informon publikun, për çdo projektakt, që do të futet në procedurat e shqyrtimit e të miratimit, si dhe njofton publikun e ndikuar, OJF-të mjedisore dhe grupet e tjera të interesit, në formë elektronike dhe shkresore.

2. Njoftimi hartohet me shkrim dhe publikohet vazhdimisht gjatë një muaji.

Njoftimi, i cili shoqërohet me projektaktin normativ dhe relacionin përkatës, përcakton;

a) afatin kohor për studimin nga publiku, i cili nuk mund të jetë më pak se 10 ditë kalendarike nga data e dërgimit të projektaktit për njohje;

b) vendin, datën dhe orën e organizimit të diskutimit të projektaktit;

- c) identitetin e autoritetit publik, përgjegjës për vendimmarrjen.
3. Përfaqësuesit e ministrisë drejtojnë takimin dhe grupi hartues i projektit mban procesverbalin.
4. Grupi hartues i aktit ripunon projektin përfundimtar, duke vlerësuar sugjerimet e publikut dhe të grupeve të interesit.
5. Në relacionin, që shoqëron projektin përfundimtar, pasqyrohen vërejtjet e publikut, të cilat nuk janë reflektuar në material, duke dhënë edhe arsyet.
6. Në përfundim, organit vendimmarrës i përcillet varianti përfundimtar i projektaktit, relacioni shoqërues, bashkë me procesverbalin e debatit me publikun.
7. Projektaktet normative, që i kushtohen mbrojtjes së mjedisit, nuk mund të miratohen nëse nuk plotësojnë kërkesat e këtij kreu, për tërheqjen e mendimit të publikut.
8. Tërheqjes së mendimit të publikut dhe të grupeve të ndikuara, sipas dispozitave të këtij kreu, u nënshtrohen edhe projektaktet, që hartohen në kuadër të projekteve, si dhe ato, që ndërmerren jashtë parashikimeve të matricës. Në këto raste, debatin me publikun dhe pasqyrimin e kërkesave në projektin përfundimtar e realizojnë projektet dhe produkti i tyre nuk merret në dorëzim, nëse nuk janë plotësuar këto kërkesa.

#### KREU IV

#### PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMET PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARIVE ME NDIKIM NË MJEDIS

1. Autoritetet publike, që licencojnë veprimtari me ndikim në mjedis, sigurohen me dokumente se propozuesi i veprimtarisë:

- a) ka marrë miratimin e organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit do të ushtrohet veprimtaria, për instalimin dhe funksionimin e veprimtarisë;
- b) ka vënë në dijeni publikun e ndikuar dhe ka komunikuar, paraprakisht, me të, për veprimtarinë, që do të ushtrojë;
- c) ka marrë, sipas rastit, deklaratë mjedisore, leje mjedisore, leje të integruar, autorizimin ose pëlqimin mjedisor, në kuadër të të cilave është kryer edhe këshillimi me publikun e interesuar.

2. Kërkesat e shkronjave “a” e “b” nuk zbatohen kur projekti a veprimtaria, që do të ushtrohet, ka të bëjë me mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, kur në dokumentet e tyre ka informacion, që klasifikohet “Sekret shtetëror” apo, për arsye konfidencialiteti, teknologjik e tregtar.

3. Për veprimtaritë, që kanë ndikim në mjedis, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave siguron pjesëmarrjen e publikut, duke zbatuar këto procedura:

a) Brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për t’u pajisur me leje mjedisi, i kërkon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, ku do të zbatohet projekti, të organizojë diskutimin me publikun e ndikuar;

b) Dërgon në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dokumentet e projektit a të veprimtarisë, për t’ia vënë në dispozicion publikut.

Me këto dokumente kuptojmë:

- i) Një përmbledhje të projektit teknik dhe të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të veprimtarisë, e cila hartohet nga kërkuesi në 10 kopje;
- ii) Projektletjen mjedisore për veprimtarinë, në 5 kopje;
- iii) Tri kopje të dosjes së plotësuar nga kërkuesi, kur pjesëtarë të publikut duan të njihen në mënyrë të plotë me të.

c) Materialet e kërkuara në shkronjën “b” të kësaj pike, hartohen në gjuhën shqipe dhe me terminologji të thjeshtë.

4. Njësia e qeverisjes vendore dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të

Ujërave me mjetet e mundësitë, që kanë, njoftojnë publikun e ndikuar, brenda 5 ditëve, nga data e marrjes së dokumenteve të përmendura në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij vendimi.

5. Njoftimi hartohet me shkrim dhe publikohet gjatë 20 ditëve pa ndërprerje:

- a) në radio e tv-të vendore;
- b) në faqen e internetit të organit;
- c) në botime të përditshme apo periodike, kur është e mundur;
- ç) në tabelën e njoftimeve të njësisë së qeverisjes vendore.

6. Njoftimi i qeverisjes vendore përcakton:

- a) vendin, ku qëndron i depozituar dokumentacioni;
- b) afatin kohor për dhënien e mendimit, i cili është jo më pak se 1 muaj nga data e fundit e shpalljes së njoftimit;
- c) vendin, datën dhe orën e organizimit të diskutimit me publikun e ndikuar.

7. Në diskutimin me publikun marrin pjesë specialistë të ministrisë, kërkuesi, me ekspertët e certifikuar, që kanë përgatitur raportin e VNM-së, specialistë të ministrive, që kanë lidhje me këtë veprimtari.

8. Specialistët e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave mbajnë procesverbalin e takimit, ku shënohen të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e publikut.

9. Vërejtjet pasqyrohen në projektletjen. Për propozimet, që nuk reflektohen, jepen argumentet përkatëse.

10. Për veprimtaritë, që miratohen me pëlqim dhe autorizim mjedisor, procedurat e përcaktuara në pikat 3-6 të këtij kreu, zbatohen nga agjencitë rajonale të mjedisit.

11. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe agjencitë rajonale të mjedisit i zbatojnë procedurat e pjesëmarrjes së publikut, të përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi, edhe në rastet e rishikimit apo të ndryshimit të një lejeje mjedisore.

## KREU V

### PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË KONTROLLIT MJEDISOR

1. Për të mundësuar tërheqjen e mendimit të publikut në kontrollet mjedisore të Inspektoratit të Mjedisit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave informon publikun edhe përmes publikimit në faqen e internetit të:

- a) programeve vjetore të kontrollit të Inspektoratit të Mjedisit;
- b) programeve vjetore të monitorimit të mjedisit e të përbërësve të tij;
- c) planeve mujore të agjencive rajonale të mjedisit.

2. Në grupet e kontrolleve, që organizohen nga Inspektorati i Mjedisit, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të qeverisjes vendore, në territorin e së cilës do të ushtrohet kontrolli, si dhe përfaqësues të publikut e të OJF-ve mjedisore, nëse ka prej tyre një kërkesë me shkrim.

3. Raportet e grupit të inspektimeve, në përfundim të kontrollit, përfshijnë edhe komentet, vërejtjet apo sugjerimet e publikut, që ka ndjekur inspektimin.

4. Një kopje e raportit të kontrollit depozitohet në njësinë e qeverisjes vendore dhe ajo është e hapur gjatë një muaji, për t’u lexuar nga publiku.

5. Ngarkohen autoritetet publike, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të kreut I të këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**